

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH
(TË SHOQËRISË “TIRANAKONS 2020” SHPK)

Sot, në datë 18/12/2023, në Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme për të nënshkruar këtë Kontratë shit-blerje kuotash (këtu e më poshtë referuar si “**Kontrata**”):

PALA SHITËSE:

- 1. ARJAN PELUSHI**, i datëlindjes 09.02.1962, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal G20209127U, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2. EDMOND TAHIRLLARI**, i datëlindjes 27.08.1962, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal G20827024G, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

(këtu e më poshtë të quajtur “**Shitësi**” ose “**Shitësit**”);

DHËNËSE PËLQIMI: **Zj. ANILA PELUSHI**, e datëlindjes 18.02.1964, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal G45218219J, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Zj. KLODJANA TAHIRLLARI, e datëlindjes 06.09.1975, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal H55906040P, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;


Dhe

PALA BLERËSE:

- 1. AGIM BABOÇI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.09.1952, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal F20911086J, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2. “DOBI MANAGEMENT” SHPK**, shoqëri tregtare e regjistruar në QKB, me NUIS L01605034R, me adresë: Kashar, Katundi i Ri, Autostrada Tiranë – Durrës, Km 8, zk. 2119, Pas. Nr. 164/54, përfaqësuar nga administratori **Z. Erjon Dobi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25.03.1992, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal J20325068V, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

(këtu e më poshtë të quajtur “**Blerësi**” ose “**Blerësit**”).

Shitësi dhe Blerësi, të cilët referohen bashkërisht si “Palët” dhe individualisht si “Pala”.



DEKLARIME

- I. **“TIRANAKONS 2020” SHPK**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Shqipëri, me seli në Njësinë administrative Nr. 6., Rruga “Feti Gjilani”, Nr. 1, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit L91723026N, me kapital të regjistruar prej 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota.
- II. Shitësit do t’i shesin Blerësve pjesë nga kuotat e zotëruara prej tyre, respektivisht 43.33 % të Kapitalit të Shoqërisë, dhe Blerësit do të blejnë respektivisht pjesët nga kuotat e zotëruara prej Shitësve që përfaqësojnë 43.33 % të Kapitalit të Shoqërisë.
- III. **ATËHERË**, Palët, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, datë 18/12/2023 të shoqërisë **“TIRANAKONS 2020” SHPK** dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve Nr. 105, datë 18/12/2023 të shoqërisë **“DOBI MANAGEMENT” SHPK** (bashkëlidhur kësaj Kontrate), bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti

- Shitësi/ Ortaku Arjan Pelushi, zotëruar i 1 (një) kuote, në masën 50 % të vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, bie dakort t’i shesë Blerësve, respektivisht sa më poshtë:
 - **AGIM BABOÇI i shet 10 % të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, në vlerën 10, 000 (dhjetëmijë) Lekë;**
 - **Shoqërisë “DOBI MANAGEMENT” SHPK i shet 13.33 % të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, në vlerën 13, 330 (trembëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë) Lekë;**
- Shitësi/ Ortaku Edmond Tahirllari, zotëruar i 1 (një) kuote, në masën 50% e vlerës së kapitalit themeltar të shoqërisë, bie dakort t’i shesë Blerësit, sa më poshtë:
 - **AGIM BABOÇI, i shet 20% të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, në vlerën 20,000 (njëzetë mijë) Lekë;**

Sa më sipër pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë “TIRANAKONS 2020” SHPK ndahet përfundimisht si më poshtë:

- **Arjan Pelushi** me pjesëmarrje 26.67 % në kapitalin themeltar.
- **“DOBI MANAGEMENT” SHPK** me pjesëmarrje 13.33 % në kapitalin themeltar.
- **Agim Baboçi** me pjesëmarrje 30 % në kapitalin themeltar.
- **Edmond Tahirllari**, me pjesëmarrje 30% në kapitalin themeltar.

Neni 2 Pagimi i çmimit

2.1 Palët bien dakord se çmimi i përqindjes së pjesëmarrjes në kuotat respektive, sipas përcaktimeve në nenin 1 më sipër do të paguhet nga Blerësit në llogarinë bankare të Shitësve me përshkrimin *“likujdim i vlerës të përqindjes së pjesëmarrjes në kuotë”*. Ndyshimi i disa termave në përshkrim, nuk sjell pavlefshmërinë e transaksionit kur qëllimi për të cilin lidhet kontrata është përmbushur.

Neni 3 Transferimi i pjesëmarrjes në kuotë

3.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Palët deklarojnë se:



Eq. 2

- i. Shitësit janë Ortakë dhe zotëruesit e ligjshëm të 2 (dy) kuotave në Shoqërinë “TIRANAKONS 2020” SHPK, të cilat përfaqësojnë 100 % të kapitalit të Shoqërisë (“**Kuotat**”).
- ii. Shoqëria “TIRANAKONS 2020” SHPK, në cilësinë e Kredimarrësit, ka hyrë në një marrëdhënie kredie me “Bankën Credins” SHA, në cilësinë e Kredidhënësit, duke nënshkruar Kontratën e Kredisë Nr. 1931 Rep., Nr. 694 Kol., datë 07.03.2023 me shumë kredie 1.100.000 (një milion e një qind mijë) Euro (“**Kredia**”).
- iii. Shitësit, si garanci për shlyerjen e Kredisë të Shoqërisë “TIRANAKONS 2020” SHPK, kanë vendosur barrë siguroese, në favor të “Bankës Credins” SHA, mbi Kuotat që Shitësit zotërojnë në shoqërinë “TIRANAKONS 2020” SHPK.
- iv. Blerësit deklarojnë se janë në dijeni të faktit se Kuotat janë të barrësuara dhe janë dakort që ato të vazhdojnë të qëndrojnë të barrësuara në favor të “Bankës Credins” SHA dhe mbas transferimit të pjesëmarrjes në Kuotë sipas kësaj Kontrate, si garanci për shlyerjen e Kredisë të Shoqërisë “TIRANAKONS 2020” SHPK.

3.2 Palët janë në dijeni të faktit, se duke qënë se Kuotat janë të barrësuara në favor të “Bankës Credins” SHA, *transferimi i pjesëmarrjes në to nëpërmjet shitblerjes*, kërkon dhënien e pëlqimit nga “Banka Credins” SHA. Për rrjedhojë, pavarësisht datës kur kjo Kontratë nënshkruhet nga Palët, kalimit i të drejtave të pronësisë mbi pjesëmarrjen në Kuota nga Shitësit tek Blerësit do të bëhet efektiv nga momenti i dhënies së miratimit me shkrim *për transferimin e Kuotave nëpërmjet shitblerjes* nga “Banka Credins” SHA. Një kopje e deklaratës së pëlqimit nga “Banka Credins” SHA do t’i bashkëlidhet kësaj Kontrate.

Neni 4 Taksat e aplikueshme

4.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjetër, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të paguhen sipas ligjit.


Neni 5 Të ndryshme

5.1 Mos ekzekutimi nga ndonjëra prej Palëve të ndonjë të drejte në lidhje me këtë Kontratë nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë. Në asnjë rast veprimet ose mosveprimet e ndonjërit prej Palëve, me përjashtim të rastit kur pala heq dorë në mënyrë të shprehur me shkrim, nuk do të përbëjnë heqje dorë nga kjo palë nga të drejtat e lindura nga shkelja e Kontratës në tërësi apo të ndonjë dispozite të saj në veçanti. Nëse ndonjë palë heq dorë nga të drejtat e lindura nga shkelja e ndonjë dispozite të Kontratës nga ana e palës tjetër, në një apo më shumë raste, nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga të drejtat e saj në rast të shkeljes së mëpasshme të po së njëjtës dispozite, apo si heqje dorë nga zbatimi i dispozitës së shkelur.

5.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis Palëve nënshkruese.

5.3 Kjo Kontratë nuk do të ndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të Palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojë Kontratën ose pjesë të saj nuk do të jetë i detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të Palët.

5.4 Nëse ndonjë nga nenet e Kontratës shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili i korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të Palëve.



5.5 Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër. Gjuha e kësaj Kontrate në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuptuar supozime se kushtet në të duhet të interpretohet më rreptësisht kundër njëres Palë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negociimin e kësaj Kontrate.

5.6 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

5.7 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

5.8 Secila prej Palëve kontraktore garanton se, përmbush kushtet ligjore të nënshkruajë këtë Kontratë dhe bije dakord me të gjitha kushtet dhe afatet e kësaj Kontratë të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar prej tyre.

Dispozita përfundimtare



Kontrata hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Të gjitha Palët e lexuan atë dhe deklarojnë se Kontrata është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar dhe në shenjë pranimi e nënshkruajnë atë.

PALËT NË KONTRATË

PALA SHITËSE:

Z. ARJAN PELUSHI


Zj. ANILA PELUSHI 

Z. EDMOND TAHIRLLARI



Zj. KLODJANA TAHIRLLARI KLODJANA TAHIRLLARI




PALA BLERËSE:

“DOBI MANAGEMENT” SHPK

Përfaqësuar nga:

Z. Erjon Dobi



Z. AGIM BABOÇI





TIRANJA KONS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

DEKLARATË NOTERIALE

Nr. repertori: 40

Nr. koleksioni: 16

Tirane më 04/01/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053950002982838



DEKLARATE NOTERIALE

Sot me date 04.01.2024, para meje Julian Zhelegu, noter prane Dhomes se Noterise TIRANE, u paraqiten personalisht:

Znj. Entela HAXHIALIU, lindur me 16.03.1973, me Leternjoftim Nr. 033955749 dhe numer Personal H35316047J, ne cilesine **Drejtor Dege , Dega Tirana 1**, prane “BANKA CREDINS” SH.A., regjistruar ne Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, regjistruar ne organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensë nga Banka e Shqipërisë Nr.16, datë 31.03.2003.

Z. Kliton SOVJANI, lindur me 13.11.1978, me Leternjoftim Nr. 037330698 dhe numer Personal H81113098F, ne cilesine e **Keshillues Klienti**, prane “BANKA CREDINS” SH.A., Tirane, regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin nr. 28969, date 31.01.2003, regjistruar ne organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensen e Bankes se Shqiperise Nr. 16 date 31.03.2003.

Te dy personat e mesiperme madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te cilet deklaruan si me poshte:

“Ne, te sipernenshkruarit, ne cilesine e perfaqesuesve ligjore te “BANKA CREDINS” SH.A. me ane te kesaj deklarate, japim pëlqimin per:

- Kalimin e pronesise se 23.33% te kuotave qe z. Arjan Pelushi zoteron ne shoqerine tregtare TiranaKons 2020 SH.P.K. me NUIS Nr. L91723026N, me Seli ne adrese: Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Feti Gjilani, Nr. 1, Tirane, sipas parashikimeve Kontrate Shitblerje Kuotash (te shoqerise TiranaKons 2020 SH.P.K.) date 18.12.2023, nga te cilat 10% te kuotave do i kalojne z. Agim Baboci dhe 13.33% te kuotave do i kalojne shoqerise tregtare DOBI MANAGEMENT Sh.p.k. me NUIS L01605034R, me kusht qe edhe pas ndryshimit te pronesise, kuotat te vazhdojne të qëndrojnë te bllokuara duke mbartur te gjitha bllokimet që aktualisht rëndojne mbi to në favor të “Banka Credins” Sh.a. si me poshte referuar;*
- Kuotat gjenden te bllokuara ne favor te Banka Credis Sh.a. sipas Marreveshje siguruese nr. 11288 rep, nr. 4751 kol, date 18.12.2023, noterizuar me noter Julian Zhelegu;**
- Kalimin e pronesise se 20% te kuotave qe z. Edmond Tahirllari zoteron ne shoqerine tregtare TiranaKons 2020 SH.P.K. me NUIS Nr. L91723026N, me Seli ne adrese: Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Feti Gjilani, Nr. 1, Tirane, ne favor te z. Agim Baboci, sipas parashikimeve Kontrate Shitblerje Kuotash (te shoqerise TiranaKons 2020 SH.P.K.) date 18.12.2023, me kusht qe edhe pas ndryshimit te pronesise, kuotat te vazhdojne të qëndrojnë te bllokuara duke mbartur te gjitha bllokimet që aktualisht rëndojne mbi to në favor të “Banka Credins” Sh.a. si me poshte referuar;*

- Kuotat gjenden te bllokuara ne favor te Banka Credis Sh.a. sipas Marreveshje siguruese nr. 11288 rep, nr. 4751 kol, date 18.12.2023, noterizuar me noter Julian Zhelegu;



Pas kalimit te pronesis se kuotave si me siper cituar struktura e ortakeve te shoqerise tregtare TiranaKons 2020 Sh.p.k do te ndryshoje dhe do te jete si vijon:

- z. Arjan Pelushi do te zoteroje 26.67% te kapitalit te shoqerise.
- z. Edmond Tahirllari do te zoteroje 30% te kapitalit te shoqerise.
- z. Agim Baboci do te zoteroje 30% te kapitalit te shoqerise.

Shoqeria tregtare DOBI MANAGEMENT Sh.p.k. me NUIS L01605034R do te zoteroje 13.33% te kapitalit te shoqerise.

Sa me siper, deklarojme nen pergjegjiesine tone personale.

Une, noteri, pasi degjova deklarimet e bera nga deklaruesit dhe verifikova dokumentat perkatese, konstatova se deklarata eshte ne perputhje me vullnetin e lire dhe te pavarur te deklaruesve dhe konform ligjit. Per kete arsye, une e nenshkruaj ate duke i dhene forcen e nevojshme ligjore.

DEKLARUES
"BANKA CREDINS" SH.A.

Drejtor Dege Tirana 1
Entela HAXHIALIU

Keshillues Klienti
Kliton SOVJANI

Klitor Sovjani



NOTER

Julian Zhelegu